

**Spiecapag Transadriatica**

**Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

**Së bashku me raportin e audituesit të pavarur**

## **PËRMBAJTJA**

	<b>FAQE</b>
RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	<b>1</b>
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	<b>3</b>
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	<b>4</b>
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	<b>5</b>
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	<b>6</b>
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	<b>7 – 24</b>

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

### Për drejtimin dhe ortakët e Shoqërisë Spiecapag Transadriatica

#### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Spiecapag Transadriatica** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të)

#### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

#### Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen përse i përket Shënimit .3 në pasqyrat financiare ku tregohet se ka pasiguri në lidhje me vazhdimësinë e njësisë ekonomike për të vepruar në Shqipëri. Kontrata aktuale e ndertimit do të perfundojë në fund të vitit 2020, dhe shoqëria nuk ka kontrata të tjera të lidhura për realizim të punimeve në vend dhe asnjë projekt tjetër të pritshëm që të garantojë vazhdimësinë e aktivitetit në Shqipëri. Këto kushte tregojnë për ekzistencën e një pasigurie materiale e cila mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi.

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 5.5 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këto çështje.

#### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, goftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuadojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

10 korrik 2020



**Luan Kamberi**  
Auditues Ligjor

**Spiecapag Transadriatica**  
**Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar**  
**Më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktivët afatgjata</b>			
Aktivët afatgjata materiale	6	356,898,242	470,364,347
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>356,898,242</b>	<b>470,364,347</b>
<b>Aktivët afatshkurtra</b>			
Inventarë	7	9,762,682	14,180,970
Llogari të arkëtueshme tregtare	8	5,020,920	7,361,077
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	9	2,299,133,387	3,229,647,124
Llogari të arkëtueshme të tjera	10	239,716,583	91,851,132
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	11	8,063,578	8,102,565
Mjetet monetare në arkë e në bankë	12	713,627,959	452,990,180
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>3,275,325,109</b>	<b>3,804,133,048</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>3,632,223,351</b>	<b>4,274,497,395</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali themeltar		100,000	100,000
Rezerva të tjera		2,502,721,919	1,276,228,614
Rezerva ligjore		10,000	10,000
Fitimi i ushtrimit		125,941,240	1,226,493,305
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>13</b>	<b>2,628,773,159</b>	<b>2,502,831,919</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	14	119,072,301	126,661,577
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>119,072,301</b>	<b>126,661,577</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	15	195,417,668	596,862,026
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	16	7,428,556	80,571,040
Parapagimet e arkëtuara	17	617,100,000	888,624,000
Detyrime tatimore	18	24,986,760	48,730,315
Llogari të pagueshme të tjera	19	9,444,907	216,518
Provizione	20	30,000,000	30,000,000
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>884,377,891</b>	<b>1,645,003,899</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>1,003,450,192</b>	<b>1,771,665,476</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>3,632,223,351</b>	<b>4,274,497,395</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Spiecapag Transadriatica**  
**Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	21	12,219,792,348	23,579,571,942
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	22	2,920,947	5,518,550
<b>Total të ardhura</b>		<b>12,222,713,295</b>	<b>23,585,090,492</b>
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	23	(10,394,732,683)	(18,745,966,714)
Shpenzime personeli	24	(1,191,710,274)	(2,365,712,881)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	25	(95,896,195)	(128,521,040)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	26	(312,727,802)	(717,445,010)
<b>Total shpenzime</b>		<b>(11,995,066,954)</b>	<b>(21,957,645,645)</b>
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	27	141,219	81,445
Shpenzime të tjera financiare (neto)	28	(57,784,234)	(141,535,940)
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>170,003,326</b>	<b>1,485,990,352</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>		<b>(44,062,086)</b>	<b>(259,497,047)</b>
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	29	(44,062,086)	(259,497,047)
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>125,941,240</b>	<b>1,226,493,305</b>
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>125,941,240</b>	<b>1,226,493,305</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Spiecapag Transadriatica**  
**Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar më 01 janar 2018</b>	<b>100,000</b>	<b>10,000</b>	<b>157,099,060</b>	<b>1,119,129,554</b>	<b>1,276,338,614</b>
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				1,226,493,305	<b>1,226,493,305</b>
Transferim në rezerva të tjera			1,119,129,554	(1,119,129,554)	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018</b>	<b>100,000</b>	<b>10,000</b>	<b>1,276,228,614</b>	<b>1,226,493,305</b>	<b>2,502,831,919</b>
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				125,941,240	<b>125,941,240</b>
Transferim në rezerva të tjera			1,226,493,305	(1,226,493,305)	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019</b>	<b>100,000</b>	<b>10,000</b>	<b>2,502,721,919</b>	<b>125,941,240</b>	<b>2,628,773,159</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratorët e Spiecapag Transadriatica më 30 Qershor 2020 dhe janë firmosur si më poshtë.



**Z. Eric Eros Azika**  
Përgjegjës i Departamentit të Kontabilitetit

**SPIECAPAG Transadriatica**  
**NUIS: L61920026B**  
Twin Tours, Kulla dyte, Kati 10,  
1000 Tirana



**Z. Vixente Tien TRUONG CONG**  
Administrator

**SPIECAPAG Transadriatica**  
**NUIS: L61920026B**  
Twin Tours, Kulla dyte, Kati 10,  
1000 Tirana

**Spiecapag Transadriatica**  
**Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
<b>Fitimi para tatimit</b>	170,003,326	1,485,990,352
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi	95,896,195	128,521,040
Provizion	-	5,000,000
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues:</i>		
Rënie/(rritje) në inventar	4,418,288	52,447,580
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	820,748,974	(1,551,151,445)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	(768,215,284)	371,526,710
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra	38,986	110,279,618
<b>Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>	<b>322,890,485</b>	<b>602,613,855</b>
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(79,822,616)	(294,498,465)
	<b>(79,822,616)</b>	<b>(294,498,465)</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(36,583,622)	(128,420,413)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	54,153,532	128,860,940
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues</b>	<b>17,569,910</b>	<b>440,527</b>
<b>Ndryshimi neto i mjeteve monetare</b>	<b>260,637,779</b>	<b>308,555,917</b>
Mjetet monetare në fillim të periudhës	452,990,180	144,434,263
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>713,627,959</b>	<b>452,990,180</b>

12

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



*(Vlerat janë në Lek)*

## **1. Informacion i përgjithshëm**

Spiecapag Transadriatica me formë ligjore të thjeshtë është regjistruar më 20/07/2016 në bazë të ligjit “Për shoqëritë tregtare” dhe statuti i saj. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj dhe ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është ndërtimi i linjës furnizuese të gazit pjesë e projektit të gazsjellësit natyror TAP.

Administrator i Shoqërisë është Z. Vixente Tien TRUONG CONG. Adresa e Shoqërisë është Bulevardi “Deshmoret e Kombit” Kullat Binjake, Qendra Tregtare, kati II, 1019 dhe është e regjistruar si person juridik në Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj me L61920026B.

Në 31 dhjetor 2019 shoqëria ka patur 362 punonjës, (2018: 1,021 punonjës).

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1 Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### **2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3 Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

Kontrata aktuale e ndërtimit do të përfundojë në fund të vitit 2020, dhe pranimi përfundimtar i projektit do të behet brenda vitit 2022. Shoqëria planifikon të vazhdojë aktivitetin deri në fund të periudhës së garancisë.

Momentalisht, shoqëria nuk ka kontrata të tjera të lidhura për realizim të punimeve në vend dhe asnjë projekt tjetër të pritshëm që të garantojë vazhdimësinë e aktivitetit në Shqipëri.

### **2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### **2.5 Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, janë paraqitur në shënimin nr. 5.

### **3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)**

#### **3.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale**

##### **Adoptimi i SNRF 16 “Qiratë”**

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë. Të gjitha qiratë pothuajse rezultojnë të tilla që qiramarrësi të zotërojë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës por edhe kur shoqëria të ketë marrë financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qerave si qera operationale ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësi do të kërkohet që të njohë: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç nëse aktivi në fjalë është me vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të marra me qira veç nga interesi për detyrimet e qirasë financiare në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

SNRF 16 në thelb ka të njëjtat kërkesa me SNK 17 për trajtimin kontabël të qirave në këndvështrimin e qiradhënësit. Ndaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qera të zakonshme ose qera financiare dhe të bëjë llogaritjet bazuar në llojin e qerasë.

Shoqëria ka analizuar kontratat e qirase dhe i ka eliminuar nga klasifikimi si qira financiare pasi janë:

- Qira afatshkurtra për një periudhe me pak se 12 muaj
- Qira të ndryshueshme të cilat varen nga porosi apo variabla të tjerë

Standartet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2019, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- Interesi afatgjatë në partnership dhe joint ventures – Amendimet e SNK
- Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF 2015- 2017
- Plani i ndryshimit ose zgjidhjes – Amendimet në SNK 19
- Interpretimi 23 Pasiguria mbi trajtimin e tatimit të të ardhurave
- KIRFN 23 Pasiguria mbi pozicionet e tatimit mbi të ardhurat (efektive nga 1 janar 2019)
- Përmirësimet vjetore (cikli 2015 -2017) (detyrimisht efektive për periudhën që fillon më 1 janar 2019)
- Amendimet në SNRF 9 Karakteristikat e parapagimit me kompensim negative (efektive nga 1 janar 2019)
- Amendimet në SNK 19 "Planet e ndryshimit, mbylljes ose zgjedhjes" (detyrimisht efektiv për periudhat nga ose pas 1 janar 2019)
- Amendimet në SNK 28 “Interesi afatgjatë në partnership dhe joint ventures” (detyrimisht efektiv për periudhat më ose pas 1 janar 2019)
- SNRF 17 “Kontratat e sigurimit” (detyrimisht efektiv për periudhat më ose pas 1 janar 2021)

#### **3.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara**

Bordi Nderkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standard dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standard dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

Standartet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2019:

- SNRF 17 Kontratat e sigurimeve – lëshuar në maj 2017 si zvendësim i SNRF 4 Kontratat e sigurimeve – efektive për periudhat pas 1 janar 2021
- Amendimet e SNK 1 dhe SNK 8 – efektive për periudhat pas 1 janar 2020
- Amendimet e SNRF 3 – efektive për periudhat pas 1 janar 2020

Kuadri konceptual i rishikuar për Raportimin Financiar – efektiv për periudhat pas 1 janar 2020

#### **4. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

##### **4.1 Te ardhurat dhe përfitimet nga kontratat**

Të ardhurat nga kontratat përfshijnë vlerën totale të punimeve të ndërtimit që janë kryer gjatë vitit. Përfitimet nga kontratat afatgjata njihen në bazë të përqindjes së llogaritur të punimeve të kryera. Këto përfitime nuk njihen deri në momentin që realizimi i tyre mund të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme.

Provizioni krijohet për të gjitha humbjet e ndodhura deri në datën e raportimit financiar, si dhe për të gjitha humbjet që parashikohen deri në fund të kontratës.

##### **4.2 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

<b>Kursi i këmbimit</b>	<b>2019</b>	<b>2018</b>
EUR/Lek	121.77	123.42
USD/ Lek	108.64	107.82
GBP/Lek	143.00	137.42

##### **4.3 Instrumentat financiarë**

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

**Instrumentat financiare – njohja fillestare.** Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

**Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes.** Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit.

**Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit.** Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivitetet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

#### 4. Politikat Kontabël (vazhdim)

##### 4.3 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

**Aktivitet financiarë – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare.** Kur modeli i biznesit është mbajtura e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

**Aktivitet financiarë – pakësimi i vlerës.** Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

**Aktivitet financiarë - çregjistrimi.** Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitetit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

**Detyrimet financiare – kategorite e matjes.** Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

**Detyrimet financiare – çregjistrimi.** Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhet (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

*(Vlerat janë në Lek)*

#### **4. Politikat Kontabël (vazhdim)**

##### **4.3 Instrumentat financiarë (vazhdim)**

**Kompensimi i instrumenteve financiare.** Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën individuale e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërish e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paafësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshkohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat afatshkurtra. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

*(Vlerat janë në Lek)*

## **5. Politikat Kontabël (vazhdim)**

### **4.4 Instrumentat financiarë (vazhdim)**

#### *Kapitali*

Kapitali njihet me vlerën nominale.

### **4.5 Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

### **4.6 Puna në proçes**

Puna në proçes për kontratat afatgjata llogaritet me kosto plus marzhin e fitimit, me supozimin se kjo është e matshme në mënyrë të arsyeshme pasi kemi provigjonuar pasiguritë, pakësuar me çdo humbje të ndodhur apo të parashikuar deri në përfundim të kontratës si dhe pakësuar me shumat e arkëtuara apo të arkëtueshme si pagesa progresive. Kostoja, për qëllim të kësaj llogaritjeje, përfshin të gjitha kostot direkte kontraktuale. Për secilën kontratë ku fatura bashkë me arkëtimin tejkalojnë vlerën kontabël të punës së kryer, shtesa kalon në të pagueshme dhe të ardhura të shtyra.

### **4.7 Aktive afatgjata materiale**

#### *i. Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktivitetit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivitetit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të akteveve afatgjata materiale.

Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të akteveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të akteveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

#### *ii. Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### **4. Politikat Kontabël (vazhdim)**

##### **4.7 Aktive afatgjata material (vazhdim)**

###### *iii. Amortizimi*

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

<b>Kategoria e aktiveve</b>	<b>Metoda e Amortizimit</b>	<b>Norma e Amortizimit</b>
Ndërtesa dhe instalime	Vlera e mbetur	5 %
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Mobilje e orendi	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %

Toka nuk amortizohet.

Këto norma reflektojnë më së shumti vlerën e pritshme të konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike që burojnë nga aktivet afatgjata materiale. Prodhimi në proces nuk amortizohet.

Normat e amortizimit dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në çdo datë raportimi.

###### *iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

##### **4.8 Kosto e huamarrjes**

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin të aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve. Kostot e huamarrjes kanë të bëjnë me interesin dhe kosto të tjera që janë bërë nga një shoqëri në lidhje me marrjen e fondeve.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

##### **4.9 Provizione**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

##### **4.10 Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

#### **4. Politikat Kontabël (vazhdim)**

##### **4.11 Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

##### **4.12 Përfitimet e punëmarrësve**

###### *Kontributet e detyrueshme shoqërore*

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzimi i përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

##### **4.13 Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i Shoqërisë dhe Manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

##### **4.14 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



## **5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit**

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave. Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkakimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

### **5.1. Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale**

Përcaktimi i jetës së dobishme të aktiveve bazohet në eksperiencat e kaluara me aktive të ngjashme si dhe në ndryshimet apo zhvillimet e reja teknologjike, dhe në ndryshimet ekonomike apo faktorët e industrisë. Vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve rishikohet çdo vit, ose në momentin që ka ndonjë tregues për ndryshime të rëndësishme në supozimet e ndërthuara në vlerësimin e këtyre aktiveve.

Siç është përshkruar në shënimin 4.6 Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

### **5.2. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

#### *Vlerësimi i modelit të biznesit*

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi.

Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

#### *Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")*

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesit kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

#### *Matjet humbjeve të parashikuara të kredisë*

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionesh në të cilën humbjet nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme llogariten në varësi të vjetërsisë së tyre apo periudhave të vonesave.

## **5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)**

### **5.3. Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , Në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Në mënyrë që të përcaktohet probabiliteti i një rezultati të ardhshëm, shoqëria përdor këshillues ligjor të brendshëm dhe të jashtëm.

### **5.4. Njohja e të ardhurave**

Më poshtë listohen gjykimet e bëra në aplikimin e SNRF 15 që kanë ndikim të rëndësishëm në përcaktimin e shumës dhe kohës së njohjes së të ardhurave nga kontratat me klientet.

Shoqëria plotëson kriteret e SNRF 15 paragrafi 35 për njohjen e të ardhurave përgjate kohës së kontratës. Këto kritere përfshijnë:

- Aktiviteti i Shoqërisë krijon ose përmirëson një aktiv (për shëmbull, punim në proçes) i cili kontrollohet nga klienti gjatë kohës që ai krijohet apo përmiresohet.
- Aktiviteti i Shoqërisë nuk krijon ndonjë aktiv që mund të përdoret ndryshe dhe shoqëria ka një të drejtë të ekzekutueshme me forcë për t'u paguar lidhur me performancën e realizuar deri në atë datë.

Kontrata e ndërtimit për inxhinierinë, prokurimin dhe ndërtimin e stacionit të kompresorëve dhe stacionit të matjes nuk ka një përdorim alternativ për kompaninë. Në klauzolat e kontratës me klientin parashihet që në rast të ndërprerjes së kontratës, Kompania ka të drejtë për pagesën e të gjitha punëve të kryera deri në datën e përfundimit të kontratës.

Shoqëria njih të ardhurat që lidhen me kushtet e performancës të përmbushura në kohë vetëm nëse ajo mund të masë në mënyrë të besueshme progresin ndaj realizimit të plotë të kushteve të performancës.

Kontrata me klientin trajtohet si një kusht i vetëm performance.

Shoqëria njih të ardhurat duke përdorur metodën kosto plus marzh ku kosto përcaktohet sipas metodës input të njohjes së të ardhurave. Shoqëria përjashton nga metoda input efektet e çdo inputi që nuk paraqet performancën e njësisë ekonomike në transferimin e kontrollit të mallrave apo shërbimeve tek klienti.

Shoqëria njih të ardhurat duke përdorur metodën kosto plus marzh ku kosto përcaktohet sipas metodës input të njohjes së të ardhurave. Shoqëria përjashton nga metoda input efektet e çdo inputi që nuk paraqet performancën e njësisë ekonomike në transferimin e kontrollit të mallrave apo shërbimeve tek klienti.

### **5.5. Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë**

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj..) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

Spiecapag Transadriatica

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

6. Aktive Afatgjata Materiale

	Instalime	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Pajisje informatike	Mobilje e pajisje zyre	Të tjera	Totali
<b>Kosto</b>							
Gjendja më 1 janar 2018	327,734,984	105,402,714	60,666,581	37,548,047	20,654,287	109,787,049	661,793,662
Shtesa	11,472,979	33,861,658	63,834,010	1,053,716	2,289,217	15,908,833	128,420,413
Pakësime	(77,864,578)	(80,725,848)	(2,716,250)	(437,190)		(6,921,000)	(168,664,866)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>261,343,385</b>	<b>58,538,524</b>	<b>121,784,341</b>	<b>38,164,573</b>	<b>22,943,504</b>	<b>118,774,882</b>	<b>621,549,209</b>
Shtesa		11,515,435	22,533,873	1,172,930	202,500	1,158,884	36,583,622
Pakësime	(3,895,083)	(7,151,749)	(52,446,110)	(1,509,702)		(3,006,372)	(68,009,016)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>257,448,302</b>	<b>62,902,210</b>	<b>91,872,104</b>	<b>37,827,801</b>	<b>23,146,004</b>	<b>116,927,394</b>	<b>590,123,815</b>
<b>Zhvlërësimi i akumuluar</b>							
Gjendja më 1 janar 2018	23,295,496	12,931,309	6,548,226	7,505,155	2,314,820	9,872,742	62,467,748
Amortizimi i vitit	58,582,351	19,556,667	16,894,731	7,656,583	4,055,618	21,775,090	128,521,040
Kthim amortizimi	(18,164,697)	(20,130,997)	(452,708)	(176,869)		(878,655)	(39,803,926)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>63,713,150</b>	<b>12,356,979</b>	<b>22,990,249</b>	<b>14,984,869</b>	<b>6,370,438</b>	<b>30,769,177</b>	<b>151,184,862</b>
Amortizimi i vitit	39,378,573	9,893,951	19,637,520	5,940,917	3,422,475	17,622,759	95,896,195
Pakësime	(1,420,933)	(2,167,697)	(8,613,874)	(661,983)		(990,997)	(13,855,484)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>101,670,790</b>	<b>20,083,233</b>	<b>34,013,895</b>	<b>20,263,803</b>	<b>9,792,913</b>	<b>47,400,939</b>	<b>233,225,573</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>							
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>197,630,235</b>	<b>46,181,545</b>	<b>98,794,092</b>	<b>23,179,704</b>	<b>16,573,066</b>	<b>88,005,705</b>	<b>470,364,347</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>155,777,512</b>	<b>42,818,977</b>	<b>57,858,209</b>	<b>17,563,998</b>	<b>13,353,091</b>	<b>69,526,455</b>	<b>356,898,242</b>

**Spiecapag Transadriatica**  
**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**7. Inventarë**

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Lëndë ndihmëse dhe të konsumueshme	3,133,371	12,932,337
Parapagime per blerje	6,629,311	1,248,633
	<u><b>9,762,682</b></u>	<u><b>14,180,970</b></u>

**8. Llogari të arkëtueshme tregtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Klientë	5,020,920	7,361,077
	<u><b>5,020,920</b></u>	<u><b>7,361,077</b></u>

**9. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura**

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari të arkëtueshme nga Spiecapag Shqipëria	2,299,133,387	3,229,647,124
	<u><b>2,299,133,387</b></u>	<u><b>3,229,647,124</b></u>

**10. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Të tjera llogari të arkëtueshme detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
TVSH e kreditueshme	36,891,247	60,299,276
TVSH per t'u regulluar	77,634	432,551
Detyrime doganore	1,878	16,483
Tatim mbi fitimin	64,977,133	30,815,716
Të tjera të arkëtueshme	159,669	287,106
TVSH per t'u rimbursuar	137,609,022	-
	<u><b>239,716,583</b></u>	<u><b>91,851,132</b></u>

**Spiecapag Transadriatica**  
**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**11. Parapagime dhe shpenzime të shtyra**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe më 31 dhjetor 2018 janë si mëposhtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	8,063,578	8,102,565
	<u><b>8,063,578</b></u>	<u><b>8,102,565</b></u>

**12. Mjete monetare në arkë dhe në bankë**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Likuiditete në bankë	713,089,302	452,747,142
Likuiditete në arkë	538,657	243,038
	<u><b>713,627,959</b></u>	<u><b>452,990,180</b></u>

**13. Kapitali**

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 lekë:

Rezervat ligjore më 31.12.2019 janë në vlerën 10,000 Lekë.

Rezerva të tjera më 31.12.2019 janë në vlerën 2,502,721,919 Lekë.

Fitimi i ushtrimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 është 125,941,240 Lekë.

**14. Llogari të pagueshme tregtare afatgjata**

Llogaritë e pagueshme tregtare afatgjata më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari të pagueshme tregtare	119,072,301	126,661,577
	<u><b>119,072,301</b></u>	<u><b>126,661,577</b></u>

**15. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari të pagueshme tregtare	195,417,668	596,862,026
	<u><b>195,417,668</b></u>	<u><b>596,862,026</b></u>

**Spiecapag Transadriatica**  
**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**16. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura**

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Te pagueshme tregetare nga SC Columbia	2,032,927	-
Te pagueshme tregetare nga A HAK International Branch Albania	5,395,629	80,571,040
	<u><b>7,428,556</b></u>	<u><b>80,571,040</b></u>

**17. Parapagime të arkëtuara**

Parapagime të arkëtuara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Parapagime nga klientët	617,100,000	888,624,000
	<u><b>617,100,000</b></u>	<u><b>888,624,000</b></u>

**18. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	12,076,121	26,829,785
Detyrime për tatim page	12,523,883	21,453,992
Detyrime për tatim në burim	386,756	446,538
	<u><b>24,986,760</b></u>	<u><b>48,730,315</b></u>

**19. Llogari të pagueshme të tjera**

Llogaritë e pagueshme të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paga punonjësit	9,228,390	-
Të pagueshme të tjera	216,517	216,518
	<u><b>9,444,907</b></u>	<u><b>216,518</b></u>

**Spiecapag Transadriatica**  
**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**20. Provizione**

Provizionet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Balanca në çelje	30,000,000	25,000,000
Provizioni gjatë vitit	-	5,000,000
<b>Balanca në mbyllje</b>	<b><u>30,000,000</u></b>	<b><u>30,000,000</u></b>

**21. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	12,219,792,348	23,579,571,942
	<b><u>12,219,792,348</u></b>	<b><u>23,579,571,942</u></b>

**Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:**

	<u>31 dhjetor 2019</u>
<b>Qarkullim i tatueshëm</b>	<b>12,023,751,200</b>
Zbriten vlera e pjesëve dhe materialeve të kthyer mbrapsht	(18,408,363)
Shtohen parapagimet në çelje	
Zbriten parapagimet në mbyllje	271,524,000
Korrigjohet për koston aktiveve të shitura e paraqitur neto	(54,153,542)
<b>Shuma e qarkullimit e korrektuar</b>	<b><u>12,222,713,295</u></b>
Sipas Kontabilitetit	<u>12,222,713,295</u>
<b>Diferenca</b>	<b><u>-</u></b>
Të ardhura nga këmbimet valutore	178,936,217
Të ardhura nga interest	141,219
<b>Total të ardhura deklaruar në FDP-në e Tatim Fitimit</b>	<b><u>12,401,790,731</u></b>

**22. Të ardhura të tjera**

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga shitja e aseteve fikse	51,776,246	128,466,944
Të ardhura nga shitja e materialeve	5,298,243	5,912,546
Vlera kontabel e aseteve të shitura	(54,153,542)	(128,860,940)
	<b><u>2,920,947</u></b>	<b><u>5,518,550</u></b>

**Spiecapag Transadriatica**  
**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**23. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Lëndë ndihmëse dhe e konsumueshme	564,446,009	1,150,803,402
Zbriten vlera e pjesëve dhe materialeve të kthyer mbrapsht	(18,408,363)	(49,170,930)
Lëndë djegëse	932,749,105	1,974,112,204
Pjesë këmbimi	95,522,031	219,090,673
Qira pajisjesh	3,611,511,866	5,924,737,521
Nënkontraktorë	4,971,857,210	9,049,284,950
Mirëmbajtje / riparime dhe shpenzime kampi	54,692,716	37,844,905
Transport	182,362,109	439,263,989
	<u><b>10,394,732,683</b></u>	<u><b>18,745,966,714</b></u>

**24. Shpenzime personeli**

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime për paga	1,080,649,942	2,145,647,037
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	111,060,332	220,065,844
	<u><b>1,191,710,274</b></u>	<u><b>2,365,712,881</b></u>

**25. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi**

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime amortizimi	95,896,195	128,521,040
	<u><b>95,896,195</b></u>	<u><b>128,521,040</b></u>



**Spiecapag Transadriatica**  
**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**26. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Blerje energji, avull, ujë	-	516,913
Shpenzime udhëtimi dhe diëta	103,919,544	233,839,224
Qira Zyra	119,313,029	323,485,386
Shpenzime për konsulenca	16,487,419	50,813,057
Shpenzime të ndryshme administrative	592,614	1,898,139
Shpenzime për materiale dhe mirëmbajtje zyrat	9,970,589	15,594,962
Shpenzime Telefon&Internet	9,567,165	21,286,566
Komisione dhe tarifa bankare	11,923,266	19,578,809
Tatime & taksa	553,810	3,176,547
Gjoha e dëmshpërblime	2,556,258	5,331,361
Të tjera shpenzime për personelin	6,304,806	8,745,345
Të tjera shpenzime	16,790,169	10,432,593
Sigurime	12,857,758	17,170,153
Donacione	1,891,375	575,955
Provizione për rreziqe	-	5,000,000
	<u><b>312,727,802</b></u>	<u><b>717,445,010</b></u>

**27. Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)**

Shpenzimet e interesit (neto) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Te ardhura nga interesat	141,219	81,445
	<u><b>141,219</b></u>	<u><b>81,445</b></u>

**28. Shpenzime të tjera financiare (neto)**

Shpenzimet e tjera financiare (neto) paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Humbje nga këmbimet valutote	(236,720,451)	(297,855,768)
Të ardhura nga këmbimet valutore	178,936,217	156,319,828
	<u><b>(57,784,234)</b></u>	<u><b>(141,535,940)</b></u>

**Spiecapag Transadriatica**  
**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**29. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>170,003,326</b>	<b>1,485,990,352</b>
<b>Total shpenzime të panjohura</b>	<b>123,743,916</b>	<b>243,989,962</b>
Shpenzime udhëtimi	98,357,932	201,453,105
Gjoha dhe penaltitete	2,556,258	5,331,361
Shpenzime pa dokumenta të regullta tatimore	20,938,351	17,539,235
Tatim në burim paguar nga furnitori	-	14,666,261
Provizion	-	5,000,000
Dhurata	1,891,375	-
<b>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</b>	<b>293,747,242</b>	<b>1,729,980,314</b>
<b>Tatim fitimi @15%</b>	<b>44,062,086</b>	<b>259,497,047</b>
	<b>125,941,240</b>	<b>1,226,493,305</b>

**30. Palët e lidhura**

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme me palët e lidhura paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>31 dhjetor 2019</b>		<b>31 dhjetor 2018</b>	
	<b>Të arkëtueshme</b>	<b>Të pagueshme</b>	<b>Të arkëtueshme</b>	<b>Të pagueshme</b>
Spiecapag Shqipëria	2,299,133,387	-	3,229,647,124	-
A HAK International Branch Albania	-	5,395,629	-	80,571,040
Spiecapag Francë	-	2,032,927	-	-
	<b>2,299,133,387</b>	<b>7,428,556</b>	<b>3,229,647,124</b>	<b>80,571,040</b>

**31. Ngjarje pas bilancit**

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 5 "vlerësimet kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime kontabël ose shënime shpjeguese shtesë të pasqyrat financiare.